



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.169/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Rrustem Thaqi dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi, duke vendosur përkitazi me ankesën e BIRN dhe IKS, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të bërjes së fushatës zgjedhore me fëmijë të mitur, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 06 tetor 2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 04.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.169/2019 e datës 01.10.2019, e paraqitur nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe IKS, me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Me datën 01.10.2019, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga BIRN dhe IKS me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se me datën 01.10.2019, rreth orës 14:52, kemi vërejtur se kandidati për deputet nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës, Uran Ismajli, në rrjetin e tij social në instagram, me datë 25.09.2019, në ditën kur zyrtarisht ka filluar fushata për zgjedhjet e 6 tetorit, ka shpërndarë një video në të cilën shfaqet një vogëlushe 13 vjeçare, duke e falënderuar për listën e barnave esenciale. Kandidati në fjalë me rastin e publikimit të kësaj video ka shënuar edhe numrin e tij në këto zgjedhje, si dëshmi për këtë në ankesë gjenden të bashkangjitura edhe fotografitë dhe video. Me anë të kësaj video vlerësojmë se kandidati për deputet është munduar që të përfitojë vota emocionale, ku në fund të postimit shkruan “Bashkë ndreqim”, kështu duke vepruar në kundërshtim me rregulloren 13/2013 e plotësuar me rregulloren 20/2019 për Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimi për Ngjarjet, përkatësisht nenin 5 paragrafi 3 pikën d).

Subjekti politik PDK, në përgjigje në ankesë të datës 02.10.2019, konsideron se nuk është shkëlur Rregulla Zgjedhore Nr. 13/2013, e plotësuar me Rregulloren Nr. 20/2019, për Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimi për Ngjarjet, përkatësisht nenin 5 par. 3 pikën d), duke theksuar se kjo video ka të bëjë me aktivitetet e Uran Ismajlit si Ministër i Shëndetësisë, jashtë fushatës zgjedhore, e jo me fushatën zgjedhore të PDK-së dhe as me Uran Ismajlin si kandidat, sepse ajo është publikuar me datë 23.09.2019 në profilin “facebook dhe instagram” të Uran Ismajlit, kjo dëshmohet me fotografitë të cilat i kemi bashkangjitur në përgjigje.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar.

PZAP-i, vendimet e tij e bazon në dëshmi të qarta dhe bindëse siç është përcaktuar me nenin 117 paragrafi 3, i LZP-së, e që në rastin konkret dy fotografit dhe CD-video, te prezantuar si prova materiale nga ankuese, për shkeljen e pretenduar nga kandidati për deputet Uran Ismajli, nga radhët e subjektit politik PDK, se i njëjti ka thyer kodnin e mirësjelljes me rastin e publikimit të videos lëndore.

Paneli pasi ka shikuar videon e publikuar ka vërtetuar faktin se kjo video nuk përmban material promovues për fushatën zgjedhore, nga shikimi në profilin e instagrmit të Uran Ismajli, e njëjta video është publikuar para se të filloj fushata zgjedhore për zgjedhjet e përkohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, andaj ankesa nuk është e bazuar, ngase prej dy fotografive dhe CD-video-së, që gjendet në shkresat e lëndës nuk mund të konstatohet ndonjë material promovues me karakter politik të fushatës zgjedhore, me qëllim të përfitimit të votave në mënyrë emocionale, siç është pretenduar në ankesë.

Andaj paneli erdhi në përfundim se janë të paqëndrueshme përshkrimet në ankesë, se është thyer Kodi i Mirësjelljes sipas Rregullës Zgjedhore Nr. 13/2013, e plotësuar me Rregulloren Nr. 20/2019, për Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimi për Ngjarjet, përkatësisht nenin 5 paragrafi 3 pika d), nga subjekti politik PDK.

Nga arsyet e theksuara më lartë, duke bazuar nenin 118 paragrafi 1 i LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.169/2019 më datën 04.10.2019

Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.